



**Ligji nr. 10455, datë 21.7.2011**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 076, DATË 12.2.2009 “PËR SIGURIMIN E  
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

**Kushtet dhe tarifat e sigurimit të detyrueshëm**

1. Autoriteti miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve.

2. Shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe fillon t'i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht autoritetin. Pavarësisht tarifave të liberalizuara të primit të sigurimit të detyrueshëm, shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervat teknike dhe provigjonet, jo më pak se niveli I rezervave teknike dhe provigjoneve, të përcaktuara nga autoriteti, si në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur autoriteti vëren se kushtet e përgjithshme të sigurimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, miraton vendime, të cilat trajtojnë mënyrën, sipas së cilës shoqëria e sigurimit duhet t'i përputhë ato.”.

**Neni 2**

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 3 ndryshohet si më poshtë:

“b) zbaton kushte të përgjithshme sigurimi, në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji.”.

2. Shkronja “b” e pikës 5 shfuqizohet.

**Neni 3**

Në nenin 59, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pikat 1 dhe 5 të nenit 100 të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, të ndryshuar, shfuqizohen.”.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7069, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë**